



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 17 nën e) si dhe nenit 40 alineja 2 nën l) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 40 alineja 2 nën piken 11) si dhe nenit 80 nën f) të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 12 paragrafi 7 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës nr. 03/L-153, nenit 8 pika j) e Udhëzimit Administrativ nr.05/2010 për Mbrojtjen e pyjeve, përgjegjësi dhe obligimeve të rojës së pyllit, me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, me Propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 01Nr.06-2833/19 të datës 18.01.2019, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-re të rregullt për vitin 2019, të mbajtur me datën 31.01.2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. Për mosdhënie të Pëlqimeve të reja nga organi kompetent i Komunës së Klinës, operatoreve ekonomik që ushtrojnë veprimtarinë afariste gurore me minim (minerare)-gurthyes, në këto zona kadastrale: që shtrihen në anën e majtë të rrugës magjistrale Pejë- Prishtinë prej Dollcit deri në vijën kufizuese administrative me Komunën e Malishevës, Drenasit dhe pjesën tjetër që fillon prej Klinafcit e që shtrihet në anën e djathtë të rrugës Klinë-Skenderaj deri të kufiri administrativ me Komunën e Skenderajt.
- II. Vendimi si në pikën 1 miratohet duke parë shkatërrimin e mjedisit që po ndodh çdo ditë e më shumë nga veprimtaria e gurthyesve, dëmtimi i pyllit, ndotja e ajrit dhe gjelbërimit.
- III. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim nga Kuvendi i Komunës, konform nenit 81 të Ligjit Për Vetëqeverisëse Lokale 03/L-040 si dhe 7 ditë pas publikimit në Web faqen e Komunës.

Më këtë vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtorja e BZHR, Drejtorja e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Zyra Ligjore, Zyra për Informim, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-2833/19
Klinë me 06.02 /2019



Kryesuesi,
Zeqir Morina
Anëtari me i vjetër i Kuvendit